

L I G J
Nr.8112, datë 28.3.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7971, DATË 26.7.1995 “PËR PROKURIMIN
PUBLIK”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8074, DATË 22.2.1996**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.8074, datë 22.2.1996, bëhen këto ndryshime:

- Në nenin 2, paragrafi i tretë, rreshti i parë, hiqen fjalët “fizik a”.

- Paragrafi i fundit, i nenit 2 ndryshohet si më poshtë:

““Fondi publik” do të thotë çdo vlerë monetare e buxhetit të shtetit, e të ardhurave të ndërmarrjeve shtetërore a shoqërive tregtare, në përbërjen e kapitalit të të cilave shteti zotëron mazhorancën.”

- Në nenin 12, pika 5, shtohet:

“Në këtë rast enti prokurues mund t’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik përjashtimin e kandidatit nga të gjitha prokurimet publike për një periudhë kohe deri në një vit. Nëse APP e miraton këtë përjashtim, do ta botojë në buletin e prokurimit publik”.

- Në nenin 12, pika 6, ndryshohet si më poshtë:

“(6) Enti prokurues duhet të skualifikojë një kandidat, në qoftë se konstaton në çdo kohë, deri në nënshkrimin e kontratës, që informacionet e paraqitura lidhur me kualifikimin ose të dhënat që kanë lidhje me vlerësimin e kandidatit, janë të pasakta ose jo të plota”.

- Në nenin 13, pika 3, pas fjalëve “në procedurën e tenderit të hapur” shtohet:

“duke iu përmbytur kufijve kohorë të përcaktuar në rregullat e prokurimit për procedurën parakualifikuese”.

- Në nenin 18, pika “a”, në fund të paragrafit të hiqet fjala “dhe”.

- Në nenin 19, pika 1, në fillim të nënpikës (ç) të shtohen fjalët e mëposhtme:

“sipas kufizimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit...”

- Në nenin 19, pika 1, shtohet nënpika (ë) si më poshtë:

“(ë) për vazhdimin e shërbimeve të projektimit që janë të lidhura me shërbime të tjera të kryera më parë, të cilat, po t’i jepen një subjekti të ri, do të cenonin të drejtën e autorit”.

- Në nenin 30, pika 1 ndryshohet si vijon:

“(1) Ofertat duhet të paraqiten me shkrim, të nënshkruara, të vulosura dhe të mbyllura në një zarf, në vendin, datën dhe orën e caktuar për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në ftesën për ofertë. Zarf i ofertës përmban dokumentacionin për kualifikimin e kandidatëve dhe ofertën tekniko-ekonomike të mbyllura në dy zarfe të veçanta. Në tenderat ndërkombëtarë ofertat mund të pranohen edhe para datës së përcaktuar për hapjen e tyre, duke përcaktuar në ftesën për ofertë afatin e fundit të paraqitjes së tyre. Në këto raste enti prokurues, mbi bazën e kërkesës, do të pajisë ofertuesin me një dokument, ku tregohet data dhe koha e marrjes së ofertës së tij”.

Në nenin 31, pika 1, pas fjalëve “e cila” shtohen fjalët “për tender ndërkombëtar”.

Në nenin 31, pika 3, pas fjalëve “çdo ofertë” shtohen fjalët “të kualifikuar”.

Në nenin 31 të shtohet pika 4 si vijon:

“(4) Zarfet tekniko-ekonomike të ofertave të skualifikuara për shkak të mosplotësimit të kërkesave për kualifikim, duhet t’u kthehen të pahapura ofertuesve që i kanë paraqitur ato”.

Në nenin 40, pika 1, në fund të paragrafit të hiqen fjalët “nëse ka mundësi”.

Në nenin 44, pika 3 ndryshohet si vijon:

“Në rast se kryetari i entit prokurues nuk do të nxjerrë një urdhër me shkrim brenda kohës së përcaktuar në paragrafin (2), ose në qoftë se kandidati nuk është i kënaqur me vendimin e kryetarit të entit prokurues, ai paraqet ankesën në organin qendror ose lokal që vë në dispozicion fondin dhe, nëse përsëri nuk është i kënaqur nga zgjidhja e problemit, kandidati ka të drejtë ta paraqesë ankesën në Agjencinë e Prokurimit Publik”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1446, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha